

# TË DHËNAT PËR QEVERISJEN ENERGETIKE: KOSOVA

E përditësuar së fundi më: 15 Prill 2016

## ÇËSHTJET KRYESORE:

- Ministria e Financave sistematikisht po shkel të drejtën e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ), si agjencion i pavarur, t'i menaxhoj burimet e veta financiare.
- Vazhdon të ketë mungesë substanciale të transparencës në prokurimin publik dhe në projektet e mëdha.
- Menaxhimi i Ndërrmarjeve në Pronësi Publike (NPP) dhe i projekteve energjetike konsiderohet joeficient sipas standardeve europiane. NPP-të janë bërë sinonim i korrupsionit, inkompetencës (paaftësisë), nepotizmit dhe punësimeve të parregullta. Ekzistojnë kritere të paqarta për sa i përket shkollimit dhe eksperiencës profesionale për anëtarët e bordeve të NPP-ve, gjë e cila shtyn në emërime politike.
- Procesi i shpërbërjes së sektorit të energjisë është karakterizuar nga mungesa e transparencës dhe debateve gjithëpërfshirëse.
- Draft ligjet e reja të lidhura me sektorin e energjisë që janë në linjë me Pakon e Tretë Energjetike nuk janë të hapura për publikun.

BURIMI: Raporti Regjional i Qeverisjes Energjetike dhe Kapjes së Shtetit, SELDI, 2016.


## TABELA 1: Gjendja e liberalizimit të sektorit elektrik (pranueshmëria, hapja e tregut, rregullimi i çmimit dhe procesi i shpërbërjes)

Rregullimi i çmimit	Të gjitha tarifat e energjisë janë administrativisht të rregulluara, dhe nuk ka plane për ulje të çmimit të energjisë.
Pranueshmëria	Sa i përket 1 Janarit 2015, të gjithë konsumatorët janë të lirë të zgjedhin furnizuesin sipas dëshirës së tyre.
Hapja e tregut	Si rrjedhojë e çmimit të rregulluar si në prodhim ashtu edhe në furnizim me energji elektrike, nuk ka ndodhur ende hapja e tregut të energjisë me shumicë dhe me pakicë. Në praktikë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ia shet me çmim fiks Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), e cila shërben edhe si blerës me shumicë edhe si shpërnadës publik me pakicë, të gjithë energjinë elektrike të prodhuar.
Procesi i shpërbërjes	Kosova nuk i përmbushë kriteret për shpërbërjen e Pakos së Tretë Energjetike. Operatori i rrjetit të transmisionit, KOSTT, është shpërbërë sipas udhëzimeve të Pakos së Dytë Energjetike të BE-së. Shpërbërja ligjore e operatorit të distribuimit (KEDS) prej aktivitetit të furnizimit ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2015, atëherë kur licenca për furnizim elektrik ka kaluar nga KEDS te KESCO.

BURIMI: Raporti i Progresit për Implementimin e Ligjit për Energji nga Komuniteti European për Energji, 2015.

## SKICA: Raporti Financiar (2014)

Raporti i Borxhit Afatgjatë mbi 1 do të thotë jostabilitet financiar.  
Raport nën 1 tregon kapacitet të limituar për të mbuluar kostot e operimit të kompanisë.



BURIMI: Kalkulimet e autorit bazuar në Raportin Vjetor Financiar të NPP-ve.

## TABELA 2: Matja e Implementimit të Ligjit (Acquis) për Energjisure

Ligjet parësore	Nuk ka progres
Aktet plotësuese nën-ligjore	Në progres
Organizimi paraprak i tregut	Nuk ka progres
Balancimi i tregut kombëtar	Në progres
Liberalizimi i çmimit	Pezull / Në pritje
Shpërbërja e Operatorëve të Rrjetit të Distribuimit	Progres Domethënës
Shpërbërja e Operatorëve të Rrjetit të Transmisionit	Nuk ka progres
NRA Independence	Në progres

BURIMI: Raporti i Progresit të Komunitetit Europian të Energjisë, 2015

### REKOMANDIMET:

- Krijimi i pavarësisë financiare të ZRrE-së nga ekzekutivi.
- Përfshirja në ligj e neneve specifike që lidhen me pavarësinë e Autoritetit Kombëtar të Rregullatorit, dhe procedurat e përzgjedhjes së antarëve të bordit të Rregullatorit.
- Menaxhimi financiar i KEK-ut duhet të përmirësohet, duke themeluar një sistem funksional të kontrollit, dhe duke krijuar një menaxhim të transparencës në të hyra.
- Përmirësimi i funksionimit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Burimi: Raporti Regjional i Qeverisjes Energjetike dhe Kapjes së Shtetit, SELDI, 2016.

## PROKURIMI PUBLIC

Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë kanë një impakt të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Vlera e aktivitetëve të Prokurimit në pesë vitet e fundit përbën afërsisht 18% të GDP-së (Bruto Produktit Vendor). Ndërrmarjet në Pronësi Publike (NPP-të) janë të obliguara të draftojnë plane vjetore dhe të kryejnë auditimet me auditorë të jashtëm. Veç kësaj, të gjitha NPP-të, përfshirë këtu edhe ato të sektorit të energjisë, janë të obliguara të respektojnë rregullat e tenderimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik. Kriteri i çmimit më të ulët vazhdon të dominojë vlerën e përgjithshme të numrit total të kontratave. Pjesa e mbetur e kontratave vazhdojnë të jepen bazuar në kriteret tenderuese me avantazhin më të madh ekonomik. Sidoqoftë, shqetësimi më i madh vazhdon të mbetet në objektivitetin e dhënjes së kontratave. Procedura e Prokurimit të Hapur është përdorur në numrin më të madh të kontratave të nënshkruara në pesë vitet e fundit. Prapë se prapë, në shumë raporte dhe hulumtime të bëra nga mediet, është theksuar fakti se anëtarët e partive politike janë përzgjedhur në bordet e NPP-ve, duke i thyer kështu kriteret ligjore të përzgjedhjes. Të dhënat gojore sygjerojnë që influenca e partive politike në pushtet është e madhe si në punësimin e të afërmeve dhe anëtarëve partiak në NPP, ashtu edhe në dhënjen e tenderëve bizneseve të afërta me to.

BURIMI: Raporti Regjional i Qeverisjes Energjetike dhe Kapjes së Shtetit, SELDI, 2016.



Ky publikim u bashkë-financua nga Bashkimi Europian dhe Iniciativa Qëndrore Europiane (CEI). Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim jo-detyrimisht përkojnë me pikëpamjet e Komisionit Europian dhe Iniciativës Qëndrore Europiane.

